

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Financiar
Financial Accounting

P1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 28.09.2019

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	<u>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- PIKËT E DHËNA</u>
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
Total	100	

Problemi 1

1. Pasqyra e pozitës financiare të klubit të vallëzimit Jani më 31 dhjetor 2017 ishte si vijon:

Pasuritë jo-qarkulluese	€	€
Toka	150,000	
Paisjet dhe Mobiljet (Kosto - €40,000)	23,000	
Gjithsej pasuritë jo-qarkulluese	173,000	
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet	9,200	
Parapagimet	2,500	
Llogaria rrjedhëse bankare	2,250	
Llogaria e depozitave bankare të afatizuara për 1 vit	<u>12,000</u>	
Gjithsej pasuritë qarkulluese		<u>25,950</u>
GJITHSEJ PASURITË		<u>198,950</u>
Ekuiteti & Detyrimet		
Ekuiteti		
Fitimet e mbajtura	<u>139,450</u>	
Gjithsej Ekuiteti		139,450
Detyrimet afatgjata		
Kredi afatgjatë	<u>48,000</u>	
Gjithsej detyrimet afatgjata		48,000
Detyrimet Afatshkurta		
Llogaritë e pagueshme	8,400	
Të hyrat e shtyera nga anëtarësia	800	
Pagat e pagueshme	<u>2,300</u>	
Gjithsej detyrimet afatshkurta		<u>11,500</u>
GJITHSEJ EKUITETI DHE DETYRIMET		<u>198,950</u>

Llogaria e përmbledhur bankare e klubit për vitin 2018 ishte si vijon:

	€		€
Sallo më 1 Janar	2,250	Pagesat për furnitorët	74,700
Shitjet e biletave	166,000	Shpenzimet komunale	29,200
Arkëtimet nga anëtarësia	68,000	Pagat	75,600
Arkëtimet e qerasë	14,800	Marketing	10,000
		Pagesat e kredisë	19,600
		Pagesat për qera	10,400
		Paisjet	7,000
		Shpenzimet tjera	2,540
		Transfer në llogarinë e depozitave	10,000
		Sallo më 31 dhjetor	<u>12,010</u>
	<u>251,050</u>		<u>251,050</u>

Gjithashtu është dhënë edhe informacioni i mëposhtëm:

- | (i) | Saldot më 31 dhjetor 2018 | € |
|-----|---------------------------|-------|
| | Stoqet | 9,900 |
| | Parapagimet | 2,000 |
| | Llogaritë e pagushme | 8,000 |
| | Të hyrat e shtyera | 1,200 |
| | Pagat e pagueshme | 1,600 |
- (ii) Kredia afatgjatë është shlyer në këste vjetore prej 15,000 € pa interes. Shpenzimet e interesit për vitin 2018 janë 4,600 €, e cila shumë nuk është paguar.
- (iii) Të hyrat nga interesi në llogarinë e depozitës janë 500 €, të cilat nuk janë arkëtuar nga banka.
- (iv) Zhvlerësimi në pajisje dhe mobilje ngarkohet me 10% e kostos në vit - Metoda drejtvizore.
- (v) Klubi i vallëzimit Jani realizon të hyra nga shitja, nga anëtarësia vjetore si dhe nga lëshimi me qira i hapësirës së sallave.

KËRKOHET:

Përgatitni për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018:

- (a) Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për klubin e vallëzimit Jani. (10 Pikë)
- (b) Pasqyrën e pozitës financiare për klubin e vallëzimit Jani. (10 Pikë)

[Totali: 20 Pikë]

Zgjidhja e problemit 1

Pasqyra e të ardhurave për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018

Kompania Jani

€

Të hyrat nga shitja	166,000	
KMSH (LL/1)	<u>(73,600)</u>	
Fitimi bruto		92,400
<i>Të hyrat tjera:</i>		
Të hyrat nga anëtarësia (LL/2)		67,600
Të hyrat nga qeraja		14,800
<i>Shpenzimet operative:</i>		
Shpenzimet e sigurimit (LL/3)	(500)	
Shpenzimet komunale	(29,200)	
Shpenzimet e pagave (LL/4)	(74,900)	
Shpenzimet e marketingut	(10,000)	
Shpenzimet e qerasë	(10,400)	
Shpenzimet e zhvlerësimit (LL/5)	(4,700)	
Shpenzimet tjera	(2540)	
Totali i shpenzimeve operative		<u>(132,240)</u>
Fitimi operativ		42,560
Të hyrat nga interesi		500
Shpenzimet e interesit		<u>(4,600)</u>
Fitimi neto		38,460

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018

Kompania Jani

PASURITË

Pasuritë jo qarkulluese

Toka 150,000

Pajisjet 25,300 (23,000+7,000-4,700)

Totali i pasurive jo qarkulluese 175,300

Pasuritë qarkulluese

Stoqet 9,900

Parapagimet e sigurimit 2,000

Depozitat me afat deri në 1 vit 22,000 (12,000+10,000)

Interesi i arkëtueshëm 500

Paraja e gatshme 12,010

Totali i pasurive qarkulluese 46,410

TOTALI I PASURIVE

221,710

EKUITETI DHE DETYRIMET

EKUITETI

Fitimi i mbajtur saldo në fillim 139,450

Fitimi neto i vitit 38,460

Totali i ekuitetit 177,910

DETYRIMET

Detyrimet afatgjata

Kredia afatgjatë (48,000-19,600) 28,400

Detyrimet afatshkurta

LL/P 8,000

Të hyrat e shtyera 1,200

Pagat e pagueshme 1,600

Interesi i pagueshëm 4,600

Totali i detyrimeve afatshkurta 15,400

Totali i detyrimeve 43,800

TOTALI I EKUITETIT DHE DETYRIMEVE

221,710

LL/1

LLogaritë e pagueshme

	Saldo në fillim 8,400
Paraja e gatshme 74,700	74,300 Blerjet (shifër balancuese)
	Saldo në fund 8,000

$$\text{KMSH} = 9,200 + 74,300 - 9,900 = 73,600$$

LL/2

Të hyrat e shtyera nga anëtarësia

Të hyrat nga anëtarësia 67,600 (shifër balancuese)	Saldo në fillim 800 Paraja e gatshme 68,000
	Saldo në fund 1,200

LL/3

Parapagimet e sigurimit

Saldo në fillim 2,500	Shpenzimet e sigurimit 500 (Shifër balancuese)
Saldo në fund 2,000	

LL/4

Pagat e pagueshme

	Saldo në fillim 2,300
Paraja e gatshme 75,600	Shpenzimet e pagave 74,900 (shifër balancuese)
	Saldo në fund 1,600

LL/5

Shpenzimet e zhvlerësimit = $(40,000 + 7,000) \times 10\% = 4,700$

Problemi 2

Bilanci vërtetues për Znj. Fitore Kadiu, një kontraktuese e IT në Prishtinë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 nuk barazohet. Zonja Kadiu përfshiu një shumë prej 12,075 € në debi të llogarisë pezull për të balancuar bilancin vërtetues. Zonja Kadiu kishte identifikuar çështjet e mëposhtme, por nuk është e sigurt se si t'i përgjigjet atyre dhe ju është drejtuar juve për ndihmë dhe udhëzime për të korrigjuar çështjet:

1. Zbritja e marrë prej 210 € është debituar në llogarinë e zbritjeve të lejuara.
2. Një shpenzim i qirasë prej 1,000 € i paguar gjatë vitit është regjistruar duke debituar llogarinë e shpenzimeve të automjeteve.
3. Një pagese prej 2,000 € në lidhje me shpenzimet e sigurimit është debituar në konton e shpenzimeve të sigurimit dhe ka debituar gabim në llogarinë e pagueshme. Shuma totale për balancim të regjistrimit është regjistruar në llogarinë pezull.
4. Totali i librit ditor të blerjeve është bartur në shumën 12,348 €, ndërsa shuma e saktë ishte 12,843 €. Shuma e saktë është regjistruar tek llogaritë e pagueshme.
5. Zonja Kadiu personalisht pagoi 10,000 € për blerjen e një automjeti për biznesin e saj. Regjistrimi është bërë si në vijim:

Debi	Banka	€10,000	
Kredi	Automjeti		€10,000

6. Një parapagim i qirasë në vlerë prej 8,000 € ishte regjistruar saktë në llogarinë bankare dhe gjithashtu ishte kredituar qiraja e pagueshme. Shuma për barazim u postua në llogarinë pezull.

KËRKOHET:

- (a) Përgatitni regjistrimet kontabël për Znj. Kadiu për të regjistruar dhe korrigjuar transaksionet përkatëse nga informacionet e mësipërme për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018. (16 Pikë)
- (b) Përgatitni llogarinë pezull për Znj. Kadiu në lidhje me transaksionet e mësipërme (4 Pikë)

[Totali: 20 Pikë]

Zgjidhja e problemit 2

Shënim: Nuk është e obliguar që të paraqiten edhe regjistrime e sakta dhe ato të gabuara, kjo është vetëm për sqarim shtesë. Detyra i merr pikët e plota nëse kandidatët kanë paraqitur vetëm korrigjimet e duhura.

1. Regjistrimi i saktë

D LL/P 210

K Zbritjet e marra 210

Regjistrim i gabuar

D LL/P 210

D Zbritjet e lejuara 210

K Llogaria pezull 420

Korrigjimi

D Llogaria pezull 420

K Zbritjet e lejuara 210

K Zbritjet e marra 210

2. Regjistrimi i saktë

D Shpenzimet e qerasë 1,000

K Paraja e gatshme 1,000

Regjistrimi i gabuar

D Shpenzimet e automjeteve 1,000

K Paraja e gatshme 1,000

Korrigjimi

D Shpenzimet e qerasë 1,000

K Shpenzimet e automjeteve 1,000

3. Regjistrimi i saktë

D Shpenzimet e sigurimit 2,000

K Paraja e gatshme 2,000

Regjistrimi i gabuar

D Shpenzimet e sigurimit 2,000

D Llogaria e pagueshme 2,000

K Llogaria pezull 4,000

Korrigjimi

D Llogaria pezull 4,000

K Paraja e gatshme 2,000

K Llogaritë e pagueshme 2,000

4. Regjistrimi i saktë

D Blerjet 12,843
K LL/P 12,843

Regjistrimi i gabuar

D Blerjet 12,348
D Llogaria pezull 495
K Llogaritë e pagueshme 12,843

Korrigjimi

D Blerjet 495
K Llogaria pezull 495

5. Regjistrimi i saktë

D Paraja 10,000
K Kapitali i pronarit 10,000

D Automjeti 10,000
K Paraja e gatshme 10,000

Regjistrimi i gabuar

D Banka/Paraja e gatshme 10,000
K Automjeti 10,000

Korrigjimi

D Automjeti 20,000
K Paraja e gatshme/Banka 10,000
K Kapitali i pronarit 10,000

6. Regjistrimi i saktë

D Parapagimi i qerasë 8,000
K Paraja e gatshme 8,000

Regjistrimi i gabuar

D Llogaria pezull 16,000
K Paraja e gatshme 8,000
K Qeraja e pagueshme 8,000

Korrigjimi

D Qeraja e pagueshme 8,000
D Parapagimi i qerasë 8,000
K Llogaria pezull 16,000

b)

Llogaria pezull

S` 12,075	4)495
1)420	
3)4,000	6)16,000
s` 0	

Problemi 3

Proviseo Sh.p.k. ju ka kërkuar juve, një kontabilist të çertifikuar, për këshilla se si të llogaritni provizionet, detyrimet kontigjente dhe pasuritë kontigjente. Fundviti i kompanisë është më 31 Mars.

KËRKOHET:

PJESA A

Kontrolluesi financiar i Proviseo Sh.p.k. ju ka kërkuar që të përgatisni një raport i cili adreson në vijim:

(a) Në përputhje me *SNK 37 - Provizionet, detyrimet dhe pasuritë kontigjente*, përshkruani se çfarë kuptohet nga sa vijon:

(i) Provizion;

(ii) Detyrim kontigjent;

(iii) Pasuri kontigjente. (6 Pikë)

(b) Diskutoni kriteret e njohjes për sa vijon:

(i) Provizion;

(ii) Detyrim kontigjent

(iii) Pasuri kontigjente (6 Pikë)

PJESA B

Proviseo Sh.p.k. ofron garancion një vjeçare për pajisjet që ia shet direkt klientëve. Në fund të vitit të kompanisë, ajo po paditet nga një prej klientëve të saj për refuzimin e riparimit të pajisjeve brenda periudhës së garancionit. Proviseo Sh.p.k. beson se dëmtimi nuk mbulohet nga garancioni me arsyetimin se klienti nuk ka respektuar udhëzimet për përdorimin e pajisjeve.

Avokati i Proviseo Sh.p.k. ka këshilluar që ka shumë gjasa që kompania do të konsiderohet përgjegjëse. Nëse kjo do të ndodhë, do të rezultohet në kosto të riparimit, përfshirë shpenzimet ligjore që kapin afërsisht 30,000 €.

Kompania prodhon gjithashtu një linjë tjetër të pajisjeve që ia shet atyre me shumicë. Kompania shiti 4,000 artikuj të këtij lloji, duke përfshirë vitin e kaluar. Kjo pajisje gjithashtu ka një garancion riparimi një vjeçar. Bazuar në përvojën e kaluar, 10% e sendeve të shitura janë kthyer për riparim. Në secilin rast, 70% e sendeve të kthyer janë në gjendje të riparohen me një kosto prej 80 €, ndërsa 30% e mbetur kanë nevojë për riparim të konsiderueshëm me një kosto prej 250 €.

KËRKOHET:

Trego dhe justifikoj trajtimin e saktë në kontabilitet për çështjet e mësipërme në librat e Proviseo Sh.p.k. për vitin që përfundon më 31 mars 2019.

(8 Pikë)

[Totali: 20 Pikë]

Zgjidhja e problemit 3

RAPORT

Për: Kontabilistin financiar

Re: SNK 37 – Provisionet, detyrimet dhe pasuritë kontigjente

Data: Prill 2019

PJESA A

(a)

(i) Një provizion është një detyrim i pasigurt në kohë ose shumë. Një detyrim është një detyrim aktual i njësisë ekonomike që rrjedh nga ngjarjet e kaluara, shlyerja e së cilës pritet të rezultojë në një rrjedhje nga njësia ekonomike e burimeve që sjellin përfitime ekonomike.

(2 Pikë)

(ii) Një detyrim kontigjent është ose

(a) një detyrim i mundshëm që rrjedh nga ngjarjet e kaluara, ekzistenca e të cilit do të konfirmohet vetëm nga ndodhja e një ose më shumë ngjarjeve të pasigurta në të ardhmen, jo plotësisht nën kontrollin e njësisë ekonomike; ose

(b) një detyrim aktual që rrjedh nga ngjarjet e kaluara, por që nuk njihet sepse

(i) nuk është e mundshme që do të kërkohet një rrjedhje e përfitimeve ekonomike për të shlyer detyrimin; ose

(ii) shuma e detyrimit nuk mund të matet me besueshmëri të mjaftueshme. (2 Pikë)

(b) **(iii)** Një pasuri kontigjente është një pasuri e mundshme që rrjedh nga ngjarjet e kaluara, ekzistenca e të cilit do të konfirmohet vetëm nga ndodhja e një ose më shumë ngjarjeve të pasigurta në të ardhmen, jo plotësisht nën kontrollin e njësisë ekonomike.

(2 Pikë)

(i) Një provizion duhet të njihet kur:

(a) një njësi ekonomike ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i një ngjarje të kaluar;

(b) është e mundshme që do të kërkohet një rrjedhje e burimeve ekonomike për të shlyer detyrimin, dhe

(c) mund të bëhet një vlerësim i besueshëm për shumën e detyrimit.

Nëse ndonjë prej këtyre kushteve nuk është përmbushur, asnjë provizion nuk mund të njihet (2 Pikë)

(ii) Një detyrim kontigjent nuk njihet. Një detyrim kontigjent shpaloset, përveç nëse mundësia e një dalje të përfitimeve ekonomike është e largët, d.m.th., në përgjithësi ka më pak se 5% shans për të ndodhur.

(2 Pikë)

(iii) Një pasuri kontigjente nuk njihet sepse mund të rezultojë në njohjen e fitimeve që nuk mund të realizohen kurrë. Sidoqoftë, kur realizimi i fitimit është praktikisht i sigurt, atëherë pasuria e lidhur nuk është një pasuri kontigjente dhe njohja është e përshtatshme.

Një pasuri kontigjente shpaloset kur një hyrje e përfitimeve ekonomike është e mundshme d.m.th. > 50%. (2 Pikë)

PJESA B

(a) Trajtimi kontabël për transaksionet për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 është si më poshtë:

1. Në fund të periudhës së raportimit, Proviso Sh.p.k. konteston detyrimin (pandaj, nëse ekziston një detyrim aktual).

(1 Pikë)

Sidoqoftë, duke pasur parasysh që ka më shumë gjasa që të shpallet fajtor, bazuar në këshillat e avokatëve, një detyrim aktual supozohet se ekziston.

(1 Pikë)

Duke pasur parasysh që është duke u matur një detyrim i vetëm, bëhet një provizion për rrjedhën e rezultatit më të mundshëm p.sh. njihet një provizion për €30,000.

(1 Pikë)

2. Ekziston një detyrim aktual në fund të periudhës së raportimit bazuar në prova historike të sendeve që janë riparuar në bazë të marrëveshjes së garancionit

(1 Pikë)

Këtu, është e përfshirë një popullatë e madhe e sendeve. Prandaj, duhet të ndahet një provizion për vlerën e pritshme të rrjedhës:

(1 Pikë)

$4,000 \times 10\% \times 70\%$	\times	€80	€22,400	(1.5 Pikë)
$4,000 \times 10\% \times 30\%$	\times	€250	<u>€30,000</u>	(1.5 Pikë)
			<u>€52,400</u>	

Problemi 4

Jeta sh.p.k ka blerë 75% të aksioneve të kompanisë Petriti sh.p.k më 1 janar 2017. Pasqyrat financiare të të ardhurave të kompanive për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017 janë si në vijim:

	Jeta shpk	Petriti shpk
	€m	€m
Të hyrat	7,500	3,000
KMSH	<u>4,000</u>	<u>1,600</u>
Fitimi bruto	3,500	1,400
Shpenzimet operative	2,000	500
Fitimi para tatimit	1,500	900
Tatimi	300	120
Fitimi neto për vitin	1,200	780

Gjatë vitit, Jeta shpk i ka shitur mallra Petritit për €5m, të cilat kishin kosto prej €3m . Në fund të vitit, 50% e këtyre mallrave kishin mbetur në stoqet e Petriti sh.p.k.

Kërkohet:

- Përgatitni pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave për grupin Jeta për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017. (15 pikë)
- Gjeni sa është fitimi që ju takon mbajtësve të ekuitetit të kompanisë mëmë. (5 pikë)

Zgjidhja e problemit 4

Grupi Jeta

Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017

	€m
Të hyrat (7,500 + 3,000 - 5)	10,495
KMSH (4,000 + 1,600 - 5 + 1)	5,596
Fitimi bruto	4,899
Shpenzimet operative (2,000 + 500)	<u>2,500</u>
Fitimi para tatimit	2,399
Shpenzimet e tatimit (300 + 120)	<u>420</u>
Fitimi neto i vitit	<u>1,979</u>
<i>Tregtia ndërgrupore</i>	
Çmimi shitës	<u>5</u>
Kosto	<u>3</u>
Fitimi bruto	<u>2</u>
Fitimi i porealizuar $50\% \times 2m = 1m$	

(b) Fitimi i ndarë për :

*Mbajtësit e ekuitetit të kompanisë mëmë (shifër balancuese)	1,784.00
**Interesi jo-kontrollues (25% × 780)	195.00
	<u>1,979.00</u>

* $1,784 = 1,200$ fitimi i mëmës + $(75\% \times 780)$ e fitimit të filialës) - 1 (fitimi i porealizuar nga shitja e bërë nga mëma për filialen).

** Sqarimi në lidhje me mos korigjim për fitim të porealizuar për IJK:

Veni re që korigjimet e IJK-së ndodhin vetëm kur shitja bëhet nga filiala - kompanisë mëmë (kur fitimi i porealizuar është tek filiala). Nëse shitja bëhet nga kompania mëmë - filialës, aty nuk do të ketë korigjime të IJK-së.

Meqenëse Jeta shpk (mëma) i ka shitur Petritit shpk (filiala) atëherë nuk duhet korigjuar IJK.

Problemi 5

Durimi Sh.P.K. operon në industrinë e shitjes me pakicë dhe pasqyrat e saja financiare janë si mëposhtë:

Pasqyra e Pozitës Financiare më 31 dhjetor 2018, Durimi Sh.P.K.

	2018	2017
	€'000	€'000
Pasuritë jo-qarkulluese		
Prona, Fabrika dhe Pajisjet	1,940	1,285
Total Pasuritë jo-qarkulluese	<u>1,940</u>	<u>1,285</u>
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet	327	371
Të arkëtueshmet tregtare	189	203
Paraja e gatshme & Ekuivalentët e saj	<u>44</u>	<u>36</u>
Total Pasuritë qarkulluese	<u>560</u>	<u>610</u>
Total Pasuritë	<u><u>2,500</u></u>	<u><u>1,895</u></u>
Ekuiteti & Detyrimet		
Ekuiteti		
Kapitali aksionar	800	600
Premia e aksioneve	100	60
Fitimet e mbajtura	673	413
Rezerva e Rivlerësimit	<u>130</u>	<u>-</u>
Total Ekuiteti	<u>1,703</u>	<u>1,073</u>
Detyrimet afatgjata		
Kredia afatgjatë	<u>420</u>	<u>500</u>
Total Detyrimet afatgjata	420	500
Detyrimet afatshkurtra		
Të pagueshmet tregtare	242	212
Overdrafti bankar	95	80
Tatimi i pagueshëm	<u>40</u>	<u>30</u>
Detyrimet afatshkurtra	<u>377</u>	<u>322</u>
Total Ekuiteti & Detyrimet	<u><u>2,500</u></u>	<u><u>1,895</u></u>

**Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018,
Durimi Sh.P.K.**

	€'000
Të hyrat	7,800
Kosto e shitjes	<u>(6,900)</u>
Fitimi bruto	900
Kostot e shpërndarjes	(342)
Shpenzimet administrative	(168)
Kostot financiare	<u>(30)</u>
Fitimi para tatimit	360
Tatimi në fitim	(80)
Fitimi neto për vitin	<u>280</u>

Shënimet:

1. Prona, Fabrika & Pajisjet me vlerë neto në libra prej €200,000 ishte shitur për €160,000. Kjo pasuri kishte kosto origjinale prej €320,000.
2. Zhvlerësimi për Pronën, Fabrikën & Pajisjen gjatë vitit arriti vlerën prej €240,000.
3. Dividendët e paguar gjatë vitit arritën vlerën në €20,000 dhe janë raportuar në Pasqyrën e Ndryshimeve në Ekuitet.

Kërkohet:

Përgatitni Pasqyrën e Rrjedhës së Parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018 për Durimi Sh.P.K. në përputhje me SNK 7 *Pasqyra e Rrjedhës së Parasë*.

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 5

Pasqyra e rrjedhës së parasë për Durimi Sh.P.K. për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018

Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative	€'000	€'000
Fitimi para tatimit	360	
Rregullimet për Zhvlerësimin	240	
Humbjen nga shitja e PFP	40	
Shpenzimet e interesit	30	
	<u>670</u>	
Zvogëlimi në të arkëtueshmet tregtare	14	
Zvogëlimi në stoqe	44	
Rritja në të pagueshmet tregtare	30	
Paraja e gjeneruar nga operacionet	<u>758</u>	
Pagesa e interesit	- 30	
Pagesa e tatimit në fitim	- 70	
	<u>658</u>	
Neto rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		658
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investive		
Pagesat për blerjen e Pronës, Fabrikës & Pajisjeve	- 965	
Pranimet nga shitja e Pronës, Fabrikës & Pajisjeve	160	
Neto rrjedha e parasë nga aktivitetet investive	-	805
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Të ardhurat nga emitimi i aksioneve	240	
Pagesat nga zvogëlimi në kreditë afatgjata	- 80	
Pagesa e Dividendës	- 20	
	<u>140</u>	
Rritja neto e keshit & ekuivalentëve të keshit	-	7
	Shënimi	
Keshi & Ekuivalentët e keshit në fillim të vitit	1	44
	Shënimi	
Keshi & Ekuivalentët e keshit në fund të vitit	1	51
Shënimi 1	2013	2012
	!'000	!'000
Paraja në dorë dhe saldot në bankë	44	36
Overdrafti bankar	- 95	- 80
Keshi & Ekuivalentët e keshit	<u>- 51</u>	<u>44</u>

TOTAL PIKËT 20

Llogaritjet

Humbja nga shitja e PFP	€'000
Kosto	320
- Zhvlerësimi i akumuluar	- 120
Vlera neto në libra në datën e shitjes	200
Të ardhurat nga shitja	160
Humbja nga shitja e PFP	40

Tatimi i pagueshem

	€'000	
Pagesa e tatimit	70	Saldo` 30
Saldo ``	40	Shpenzimet e tatimit 80
	110	

Llogaria e Pronës, Fabrikës dhe Pajisjeve

	€'000	
Saldo`	1,285	Zhvlerësimi 240
Rezerva e Rivlerësimit	130	Shitja - VNL 200
Blerja e PFP(Shifer balancuese)	965	Saldo ``1,940
	2,380	